



Asociacioni i Komunave të Kosovës

R A P O R T

nga

Takimi i Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë

Prishtinë, 17 nëntor 2011

Për: Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

Nga: Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve të AKK-së

Lënda: Raport nga takimi i Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë



HYRJE

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Kryesinë e Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë organizoi takimin e radhës të këtij Kolegjiut me 17 nëntor 2011 (e enjte) me fillim nga ora 11:00 në Restorantin „Villa Gërmia“ në Prishtinë.

Takimi kishte për qëllim të diskutohej rendi i ditës i përcaktuar më parë nga Kryesia me këto pika:

- Diskutim mbi Testin e Maturës –zyra e vlerësimeve dhe standardeve MASHT
- Trajnimi i drejtorëve për menaxhimin e shkollave

Në këtë takim morën pjesë Drejtorë të Arsimit nga Komunitat e Kosovës, si dhe përfaqësues të AKK-së, përfaqësues nga MASHT si dhe përfaqësues nga GIZ, Sëisscontact, KING- ICT/EU pilot projekt si dhe Ambasada e SHBA-ve në mbështetje të programit për ngritjen profesionale të mësimit të gjuhës angleze. Takimi u kryesua nga kryesuesi i Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë z. Azem Guri.

PËRMBLEDHJE

Duke marrë parasysh agjendën e ngjeshur kryesuesi i kolegjiut pa humbur kohë propozoi ndryshimin e rendit të ditës ku edhe u miratua në parim nga pjesëmarrësit ngaqë në takim ishin prezent edhe përfaqësues të organizatave të ndryshme të cilat do të njoftonin për projektet që do të implementohen në komunitat e ndryshme të Kosovës me interes në fushën e arsimit.

Nga ana tjetër sekretari i përgjithshëm njoftoi për ndryshimet e nëntë udhëzimeve administrative deri më tash nga MASHT-i në përmirësimin e procesit arsimor. Duke marrë parasysh se deri më tash kolegjiut i arsimit dhe kulturës ka dalë më vërejtjet dhe rekomandimet e saj në funksionalitetin e përgjithshëm të punës në sektorin e arsimit, këto ndryshime të u. administrative janë në vazhdim të punës së përbashkët në mes të kolegjiut dhe MASHT-it. Deri në fund të vitit do të ketë ndryshime deri në pesëmbëdhjetë udhëzimeve administrative sipas procesit të planifikuar nga ana e Ministrisë në konsultim me drejtoritë komunale të arsimit respektivisht kolegjiut në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Në këto takime të komisioneve të cilat punojnë për nxjerrjen e këtyre udhëzimeve administrative, mendimet dhe sugjerimet e drejtorëve janë shumë të vlefshme sepse janë zyrtarët komunal ata që ballafaqohen me probleme gjatë zbatimit të tyre në terren ku edhe hasin në vështirësi të ndryshme gjatë zbatimit në terren, andaj edhe vërejtjet dhe komentet e tyre do të merren parasysh në përpilimin e tyre.

Rekomandimet e dala nga kolegjiut janë marrë parasysh deri më tash, anëtarët e saj janë treguar të gatshëm për diskutim si dhe një koordinim të përbashkët në organizimin e punës së përbashkët ku edhe është arritur sukses i konsiderueshëm dhe shpreh mirënjohje për punën e përbashkët të realizuar deri më tash.

Nefertita Bardhi nga Sëisscontact bëri prezantimin e projektit në përkrahje të arsimit profesional dhe përfitimin e granteve për shkollat profesionale, analizimi i nevojave urgjente për shkollat si dhe mënyrat e përfitimit të tyre, procesi i mbikëqyrjes, kriteret e përfitimit – kualiteti si dhe mbikëqyrja e procesit nga bordi i përzgjedhjes. Bashkangjitur në **aneksin 1** do të gjeni draftin e prezantuar në takim me pikat kryesore.

Si përgjigje ndaj këtij njoftimi ishte kërkesa që drejtorët komunal të arsimit të përfshihen në bordet të cilët do të përcaktojnë se cilat shkolla do të duhet të përfitojnë ato grante duke marrë parasysh se drejtorët janë më të informuar për atë se cilat shkolla janë më të nevojshme në përfitimin e tyre.

Drita Kadriu- këshilltare e Ministrit Buja njoftoj për Marrëveshjen e Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet MASHT-it dhe Ambasadës së SHBA-ve në mbështetje të ngritjes profesionale të mësimit në gjuhën angleze de zbatimin e tij, ndërsa Svetlana Breca - Drejtoreshë e Qendrës për burime informative në Ambasadën e SHBA-ve tregoj qëllimin e projektit dhe prezantimin e z. John Harrington (Magjistër për programet e gjuhës angleze dhe Zhvillimin e bashkësive) i cili është përzgjedhur dhe do të punojë në ngritjen profesionale të mësimit në gjuhën angleze për metodologjitë e reja duke u përqendruar në përmirësimin e komunikimit dhe përkrahjes ndër mësimit në gjuhën angleze në shkollat publike të ciklit fillor dhe të mesëm. Informatat rreth këtij projekti i gjeni të bashkangjitura në **aneksin 2**.

Po ashtu Sonja Priščan - udhëheqëse e projektit, prezantoi pilot projektin e financuar nga KE-ja në ngritjen e teknologjisë informative në fushën e edukimit. Në **aneksin 3** do të gjeni prezantimin e projektit.

Si pikë shtesë u prezantua edhe projekti ATOM nga qendra Encompass i cili ka për qëllim identifikimin dhe përkrahjen e personave me inteligjencë të jashtëzakonshme. Në **aneksin 4** gjeni pikat kryesore. Mënyrat e nominimit dhe plotësimi i kriterëve, përfitimet e mundshme të këtij projekti.

Në pikën e diskutimit sa i përket testit të maturës, takimit iu bashkëngjiti edhe Nehat Mustafa - Zëvendësministër i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë i cili njoftoi drejtorët për organizimin e konferencës vjetore i cili do të ketë për qëllim kryesor format e organizimit si dhe mbarëvajtjen e përgjithshme të testit të maturës, dhe mënyrave se si mund të përmirësohet ky proces në të ardhmen. Konferenca do të përmbajë katër punëtori sa i përket çështjeve ligjore, KQSHM, si dhe vlefshmërisë së drejtë të testit e besueshmërisë së procesit. Me këtë rast kolegjiu të dalë me rekomandime konkrete në këtë ngjarje, po ashtu propozimet e dala të jenë në përputhje me pikat dhe kushtet në të cilat funksionon sistemi arsimor në Kosovë. Është esenciale që të ketë një pjesëmarrje të gjerë nga të gjitha komunat në këtë konferencë në mënyrë që të përfaqësohen drejtë të gjitha vërejtjet për procesin e maturës.

Ndërsa Mustafë Kadriu – udhëheqës i njësive për standarde dhe vlerësime në MASHT cekuri se një konferencë e tillë ndihmon në diskutimin dhe përcaktimin e standardeve të testit të maturës, si dhe përcaktimin i kriterëve të besueshmërisë ku kontributin më të madh do të jetë ai i mësimit në gjuhën angleze si dhe drejtorëve të cilët janë të kyçur direkt në këtë proces dhe janë të informuar për problemet

konkrete. Ku proces është njëri ndër proceset më të rëndësishëm nga të gjithë proceset tjera arsimore, andaj duhet të punojmë bashkërisht që të ketë një besueshmëri tek të gjitha palët si dhe të gjithë nxënësit të fitojnë atë çka e meritojnë nga ky test. Komunitat patjetër duhet të japin kontributin e tyre, që të tregojnë përparësitë dhe mangësitë e këtij procesi, të japim shembujt se ku mund të përmirësohet si dhe të japin të dhënat e informatat e sakta në nxjerrjen e përfundimeve konkrete për testin e maturës i cili duhet të jetë i besueshëm si dhe të ketë një vlerësim të drejtë të njohurive të nxënësve.

Synimi i konferencës është që të ketë propozime të kapshme dhe konkrete për këtë proces sa i përket përcaktimit të kriterëve në mënyrë të qartë për testin e maturës, format e testit, pyetjet, si dhe kontrolli të jetë sa më në nivel në vlerësimin e nxënësve. Duke marrë parasysh se administrimi i testit të maturës bëhet nga mesimdhënësit të cilët përcaktohen nga DKA-të ata edhe janë edhe përgjegjësit kryesor për ecurinë e këtij procesi. Puna e tyre do të reflektohet në ecurinë e gjithmbarshme të këtij procesi prandaj përzgjedhja e tyre duhet të bëhet me plotësimin e kriterëve të qarta të punës profesionale, ku edhe do të certifikohen nga MASHT-i dhe mekanizmat relevant.

REKOMANDIMET:

- Kryesia të përgatisë vërejtjet dhe sugjerimet të cilat kanë dalë gjatë takimeve të rregullta të Kolegjiumit të drejtorëve të arsimit.
- Drejtorët të paraqesin vërejtjet dhe sugjerimet e tyre për procesin në mënyrë që të inkorporohen në vërejtjet e gjithmbarshme për testin e maturës shtetërore.
- Të vazhdojë bashkëpunimi me organizatat e ndryshme të huaja dhe vendore në fushën e arsimit.
- Të jepen propozimet dhe vërejtjet për ndryshime të udhëzimeve administrative.